

Udhërrëfytyesi për Viza A deri Zh Shpjegim i të gjitha koncepteve kryesore dhe termeve teknike

Ky fjalorth shpjegon të gjitha konceptet kryesore dhe termet teknike që shfaqen në udhërrëfytyesit për viza për Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë. Duke i kuptuar ato, bëhet e qartë se sa të gjera janë reformat që duhet t'i ndërmarrin këto shtete për t'u kualifikuar për udhëtime pa viza në shtetet e Shengenit. Po ashtu, bëhet e qartë se këto reforma nuk do të jenë vetëm në dobi të shteteve të Ballkanit, por ato ndihmojnë BE-në dhe e mbrojnë atë nga krimi dhe imigrimi ilegal nga e tërë bota.



Të rinjtë, sikurse këta studentë në Bosnje, presin me padurim udhëtimin pa viza për në BE. Foto: Universiteti i Tuzllës

▶ Dokumentet bazike	f. 2
▶ Kartelat e identifikimit	f. 2
▶ Përgjegjësia e transportuesve	f. 2
▶ Konfiskimi i pasurive të kriminelëve	f. 3
▶ Konventat e Këshillit të Evropës	f. 3
▶ Konventat e Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështje penale	f. 3
▶ Korrupsioni	f. 4
▶ Veprimi i përbashkët i BE-së për ndalimin e udhëtimit	f. 4
▶ Instrumentet legjislative të BE-së	f. 4
▶ Eurojust	f. 5
▶ Zyra e Policisë Evropiane (Europol)	f. 5
▶ Marrëveshjet e bashkëpunimit strategjik	f. 5
▶ Marrëveshjet e bashkëpunimit operativ	f. 6
▶ FRONTEX	f. 6
▶ Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO)	f. 7
▶ Standardet ICAO dhe EC lidhur me informatat biometrike në dokumentet e udhëtimit	f. 7
▶ Detektimi tokësor i migruesve ilegalë	f. 7
▶ Integriteti dhe siguria e procesit të personalizimit dhe distribuimit të pasaportave	f. 8
▶ Baza e të dhënave LASP/SLTD	f. 8
▶ Dokumenti i udhëtimit biometrik elektronikisht i lexueshëm	f. 8
▶ Menaxhimi i Migrimit	f. 9
▶ Monitorimi i rrjedhave të migrimit	f. 9
▶ Profilët e Migrimit	f. 9
▶ Shpëlarja e parave	f. 9
▶ Menaxhimi i integruar kombëtar i kufijve	f. 10
▶ Strategjia kombëtare për riintegrimin e të kthyerve	f. 11
▶ Ligji për mbrojtjen e të dhënave personale	f. 11

▶ Marrëveshja për ripranim	f. 12
▶ Marrëveshja bilaterale për ripranim	f. 13
▶ Protokollet e zbatimit	f. 13
▶ Dokumentet standarde të udhëtimit të BE-së për qëllime të dëbimit	f. 13
▶ Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (IDP)	f. 13
▶ Refugjatët	f. 13
▶ PZHBV	f. 13
▶ Marrëveshja e Shengenit	f. 13
▶ Listat e bardha dhe të zeza të Shengenit	f. 14
▶ SIS dhe SIV	f. 14
▶ Trafikimi me qenie njerëzore	f. 14
▶ Marrëveshja për lehtësimin e vizave	f. 15
▶ Norma e refuzimit të vizës dhe norma e refuzimit të hyrjes	f. 15
▶ Norma e refuzimit të vizës	f. 15
▶ Norma e refuzimit të hyrjes	f. 16

Dokumentet bazike

Dokumentet bazike që përdoren për të siguruar dokumentet si pasaportat, kartelat e identifikimit dhe patentë-shoferët. Dokumente tipike bazike janë certifikatat e lindjes, certifikatat e kurorëzimit, certifikatat e shkurorëzimit dhe – në disa shtete – kartelat e sigurimit social. Meqë dokumentet bazike janë bazë për dokumentet tjera, është e rëndësishme kritike që të ruhet siguria e tyre dhe të parandalohet falsifikimi apo manipulimi i tyre.

Krijimi i dokumenteve të sigurta bazike kërkon një varg aranzhimesh komplekse. Kjo përfshin mbrojtjen e dokumenteve bazike kundër falsifikimit dhe sigurimin e regjistrave të ndryshëm civilë ku ruhen të dhënat personale (siç janë data e lindjes dhe vdekjes). Zakonisht, masat e tilla përfshijnë kufizime të rrepta në qasje në regjistrat civilë, kontroll adekuat të sigurisë, tipare të sigurisë në dizajn që e bëjnë të vështirë falsifikimin e certifikatave, dublikate adekuate të cilat ruhen në mënyrë të sigurt (përfshirë baza elektronike qendrore të të dhënave), lidhjet e drejtpërdrejta në bazat burimore të të dhënave për verifikimin e informatave, si dhe programe të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse trajnimi për stafin e përfshirë në verifikimin apo identifikimin e dokumenteve (përfshirë kurse mbi ngritjen e vetëdijes për korrupsionin dhe zbulimin e mashtrimit).

Për sa i përket **personalizimit të dokumenteve të udhëtimit**, në të gjitha fazat e procesit duhet të zbatohet "parimi i katër syve" dhe "ndarja e detyrave".

Kartelat e identitetit

Udhërrëfyesit e vizave kërkojnë nga shtetet e Ballkanit që të sigurojnë "një nivel të lartë të sigurisë së dokumenteve bazike dhe **kartelave të identitetit**" dhe të përcaktojnë "procedura të rrepta të lëshimit të tyre". Kartelat e identitetit janë përfshirë sepse ato mund të funksionojnë si dokumente udhëtimi, në disa raste mund të përdoren si dokumente bazike, si dhe nevojiten për identifikimin e personave kur kërkojnë certifikata, si për shembull, certifikata të lindjes.

Përgjegjësia e transportuesve

Përgjegjësia e transportuesve i referohet obligimit të transportuesve (personave, kompanive dhe organizatave që ofrojnë transportim të udhëtarëve të llojit ajror, detar apo tokësor) për të siguruar se udhëtarët posedojnë dokumente të vlefshme të udhëtimit, përfshirë viza apo leje qëndrimi, nëse të njëjtat kërkojnë.

Transportuesit që dështojnë të zbatojnë kontroll adekuat të dokumenteve të udhëtimit dhe që lejojnë hyrjen e të huajve të paautorizuar në një shtet të caktuar janë të obliguar që t'i riadhesojnë ata me shpenzime të tyre. Po ashtu, ata do t'i nënshtrohen edhe gjobave.

Përgjegjësia e transportuesve është përcaktuar në nenin 26 të *Konventës së Shengenit* të vitit 1990, që sqaron zbatimin e **Marrëveshjes së Shengenit** të vitit 1985. Direktiva e BE-së e miratuar në vitin 2001 (2001/51/EC) plotëson nenin 26 dhe shpjegon legjislacionin mbi përgjegjësinë e transportuesve si masë "që synon frenimin e rrjedhave të migrimit, dhe luftimin e imigrimit ilegal." Për t'i arritur këto synime, udhërrëfyesit e vizave kërkojnë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor që të zbatojnë legjislacionin dhe të përkufizojnë ndëshkimet përkitazi me përgjegjësinë e transportuesve.

Konfiskimi i pasurive të kriminelëve

Legjislacioni mbi këtë çështje është i domosdoshëm për të siguruar se kriminelët nuk lejohen t'i mbajnë të ardhurat e krijuara përmes aktiviteteve kriminale. Përgjithësisht, pasuritë e kriminelëve mund edhe të konfiskohen, pa kompensim, nëse ato janë transferuar te një person tjetër. Konfiskimi i të ardhurave kriminale duhet të bazohet në vendim gjyqësor i cili përcakton se është kryer një vepër penale. Brenda BE-së, shteti anëtar mund të kërkojë ngrirjen dhe konfiskimin e pronës së lidhur me kryerjen e një veprë në cilindo shtet anëtar të BE-së.

Këshilli i Evropës ka miratuar dy konventa mbi konfiskimin e pasurive të kriminelëve (konventa e vitit 1990 dhe 2005), në bazë të të cilave BE-ja ka miratuar legjislacionin që është edhe më i rreptë sesa konventat.

Konventat e Këshillit të Evropës

Këshilli i Evropës (KiE) është institucion i veçantë si dhe më i vjetër Evropian sesa BE-ja. I themeluar në vitin 1949, kjo organizatë është me seli në Strasburg dhe ka 47 shtete anëtare përfshirë pesë shtete të Ballkanit perëndimor të cilat marrin pjesë në procesin e liberalizimit të vizave (Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia).

Këshilli i Evropës kryesisht funksionon përmes konventave. Duke hartuar konventa dhe traktate ndërkombëtare, shtetet e saj anëtare pajtohen mbi standardet e përbashkëta ligjore dhe standarde tjera. Konventat e KiE-së bëhen ligjërish të obligueshme për shtetet anëtare pasi që ato t'i kenë nënshkruar dhe ratifikuar ato, si dhe pasi t'i kenë inkorporuar dispozitat e tyre në legjislacionin vendor. Disa konventa të Këshillit të Evropës janë hapur për nënshkrim edhe nga shtetet joanëtare.

Ekzistojnë 205 traktate të Këshillit të Evropës, sipas Zyrës së Traktateve të KiE-së. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kërkohen t'i zbatojnë konventat në lëmi të ndryshme, prej korrupsionit deri te **mbrojtja e të dhënave personale** dhe bashkëpunimi gjyqësor në çështjet kriminale (shih pjesën e ardhshme).

Konventat e Këshillit të Evropës që kanë të bëjnë me

Dy traktatet origjinale të Këshillit të Evropës mbi bashkëpunimin gjyqësor në çështjet kriminale – e që herë pas here quhen "konventat amë" – janë Konventa Evropiane e vitit 1957 për Ekstradimin dhe Konventa e vitit 1959 për Asistencë Reciproke në Çështjet Kriminale. Megjithatë, ekzistojnë gjithsej 31 konventa dhe

**bashkëpunimin
gjyqësor në
çështjet
kriminale**

protokolle që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet kriminale, siç janë mbikëqyrja e kryerësve të veprave të dënuar me kusht apo të liruar me kusht, transferimi i të ardhurave në çështje kriminale, transferimi i personave të dënuar, korrupsioni, shtypja dhe parandalimi i terrorizmit, shpëlarja e parave dhe konfiskimi i pasurive nga të ardhurat e krimit, kufizimit statutore, trafikimi me genie njerëzore, kompensimi i viktimave të krimit të dhunshëm dhe krimi kompjuterik.

Shtetet e Ballkanit perëndimor kërkojnë që të zbatojnë konventa ndërkombëtare që kanë të bëjnë me bashkëpunimin gjyqësor në çështje kriminale, veçanërisht konventat e Këshillit të Evropës, si dhe t'i ndërmarrin masat që synojnë përmirësimin e efikasitetit të bashkëpunimit gjyqësor në çështje kriminale të gjykatësve dhe prokurorëve me shtet e BE-së dhe shtetet në rajon.

Korrupsioni

Luftimi i korrupsionit është prioritet për BE-në. Sikurse kanë dëshmuar kontestet mbi anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë, shumë shtete të BE-së frikësohen se anëtarësimi i shteteve të 'korruptuara' mund të zbehë standardet e integritetit të Bashkimit.

Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit i Transparency International, me siguri indeksi më i njohur global mbi korrupsionin – jep vlerësime mjaft të këqija shteteve të Ballkanit Perëndimor. Në rang prej 1 dhe 10, ku '10' simbolizon një shtet 'tejet të pastër' dhe '0' 'tejet të korruptuar', shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë marrë vlerësime prej 3.6 (Maqedonia, shteti më së paku i korruptuar në grup) dhe 3.2 (Bosnja dhe Hercegovina, shteti më i korruptuar në grup) në vitin 2008. Në anën tjetër, Sllovenia është vlerësuar me 6.7; Danimarka, shteti më së paku i korruptuar në botë sipas TI, ka marrë vlerësim prej 9.3 pikëve, ndërsa Somalia ishte shteti më i korruptuar në botë me 1.0.

Prandaj, BE-ja është e interesuar që shtetet e Ballkanit Perëndimor të zbatojnë masat kundër korrupsionit duke hartuar dhe zbatuar strategji kundër korrupsionit, si dhe plane të veprimit dhe legjislacion të ndërlidhur. Udhërrëfyesit e vizave po ashtu kërkojnë masa specifike për trajtimin e korrupsionit në agjencitë e menaxhimit të kufijve (p.sh. policia kufitare, dogana) dhe organet apo institucionet tjera që merren me dokumente të udhëtimit apo viza.

Udhërrëfyesit po ashtu kërkojnë që shtetet e Ballkanit Perëndimor të zbatojnë konventat relevante të OKB-së dhe të Këshillit të Evropës siç janë: Konventa e OKB-së e vitit 2003 mbi Korrupsionin, Konventa e së Drejtës Civile e Këshillit të Evropës e 1999 mbi Korrupsionin si dhe Konventa e së Drejtës Penale e Këshillit të Evropës mbi Korrupsionin e të njëjtit vit.

**Veprimi i
përbashkët i BE-
së mbi ndalimin e
udhëtimit**

"Veprimi i Përbashkët" është instrument ligjor i Politikës së Përbashkët së Jashtme dhe të Sigurisë të BE-së (PPJS). Është veprim i koordinuar ndërmjet 27 shteteve anëtare të BE-së për arritjen e objektivave specifike të dala nga synimet e politikave të përgjithshme të formuluar (udhëzimet) të përcaktuara nga Këshilli Evropian (presidentët apo qeveritë e BE-së). Nëse miratohet një veprim i përbashkët, mund të mobilizohen resurset të ndryshme (burimet njerëzore, ekspertiza, financimi, pajisjet, etj.).

BE-ja ka miratuar disa veprime të përbashkëta që imponojnë ndalime të udhëtimit për individë të caktuar që vijnë nga shtetet jo anëtare të BE-së. Shembull është ndalimi i udhëtimit të personaliteteve të larta të regjimit të Zimbabvesë, përfshirë

Presidentin Robert Mugabe. Kjo masë është motivuar nga angazhimi i vazhdueshëm i qeverisë së Zimbabvesë “në shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe lirisë së mendimit, asociimit dhe të tubimit paqësor.” (Për më shumë informata mbi Politikën e Jashtme të BE-së, klikoni këtu.

Instrumentet legjislative të BE-së

BE-ja ka një varg instrumentesh legjislative, ku më të rëndësishmit janë:

Rregullorja e BE-së: Ky lloj i ligjit të BE-së është i zbatueshëm në tërësinë e tij, pa asnjë ndryshim, në shtetet anëtare. Ai hyn në fuqi në një datë të caktuar, zakonisht për një periudhë shumë të shkurtër pas publikimit në Gazetën Zyrtare të BE-së. Në rast të konflikteve me ligjet vendore, mbizotëron Rregullorja.

Direktiva e BE-së: Ky lloj ligji i BE-së përcakton objektivat që duhet arritur, por vendimi për formën dhe metodën e arritjes së tyre i lihet shteteve anëtare të BE-së. Çdo Direktivë përcakton një afat, zakonisht dy apo tri vite pas miratimit në nivel të BE-së, deri në të cilën kohë shtetet anëtare duhet të kenë inkorporuar dispozitat e tij në legjislacionin vendor.

Vendimi i BE-së: Si Këshilli i BE-së (ku përfaqësohen të gjitha shtetet anëtare) ashtu dhe Komisioni Evropian mund të miratojnë Vendime. Ato janë plotësisht të obligueshme për ata të cilëve iu adresohen ato.

Eurojust

Eurojust është organ i BE-së i themeluar në vitin 2002. Me seli në Hagë, ai paraqet një rrjet të përhershëm të autoriteteve gjyqësore të ngarkuar me fuqizimin e efektivitetit të hetimeve dhe ndjekjes penale të krimit të rëndë tejkufitar dhe krimit të organizuar në shtetet anëtare të BE-së. Eurojust ka 27 anëtarë vendorë, një nga secili shtet anëtar- zakonisht një prokuror, gjykatës apo policë i lartë – të cilët kanë qasje në autoritetet gjyqësore dhe në dosjet e rasteve brenda shtetit të tyre. Po ashtu, ekzistojnë 31 pika kontaktimi të Eurojust në shtetet jo-anëtare të BE-së (2007), përfshirë të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor. Eurojust punon me ta në rastet që përfshijnë shtetin që përfaqësojnë.

Në prill të vitit 2009, për shembull, kjo organizatë ka ndihmuar në disa arrestime të koordinuara dhe të njëkohshme në Itali, Holandë dhe Kolumbi të rasteve të mëdha të trafikimit me qenie njerëzore dhe trafikimit të drogës. Roli i Eurojust në hetim ishte organizimi i takimeve koordinuese ndërmjet autoriteteve gjyqësore nga Kolumbia, Holanda dhe Italia.

Udhërrëfyesi i vizave kërkon nga shtetet e Ballkanit Perëndimor që të zhvillojnë marrëdhënie pune me Eurojust, kryesisht përmes pikave të kontaktimit të Eurojust. Synimi është avancimi i bashkëpunimit në luftimin e formave të rënda të krimit transnacional, përfshirë terrorizmin. Maqedonia madje ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me Eurojust më 28 nëntor 2008.

Zyra e Policisë Evropiane (Europol)

Europol është “organizatë shërbyese” për shtetet e BE-së pa kompetenca detyruese dhe pa forcë policore të veten. Themelimi i tij është miratuar me Traktatin e Mاستrihtit (që hyri në fuqi në 1993) dhe kjo agjenci – me seli në Hagë

është kompletuar dhe ka filluar të funksionojë prej vitit 1999.

Detyra kryesore e Europol-it është lehtësimi i bashkëpunimit ndërmjet agjencive të zbatimit të ligjit të BE-së "në parandalimin dhe luftimin e terrorizmit, trafikimit të paligjshëm të drogës dhe formave tjera të rënda të krimit të organizuar ndërkombëtar." Kjo arrihet përmes këmbimit të informatave, analizave të inteligjencës, ekspertizës dhe trajnimeve.

Marrëveshjet mbi bashkëpunimin strategjik

Europol-i bashkëpunon për së afërmi me të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor dhe ka përmbyllur **marrëveshje të bashkëpunimit strategjik** me to në mënyrë që të rritë bashkëpunimin në luftimin e formave të rënda të krimit ndërkombëtar përfshirë trafikimin e drogës, shpëlarjen e parave dhe imigrimin ilegal. Marrëveshjet sigurojnë si në vijim:

Këmbimin e informatave strategjike dhe teknike; *informatat strategjike përfshijnë* p.sh. informata mbi veprime të zbatimit, rrugët dhe metodat e shfrytëzuara nga kontrabanduesit, vlerësimet e rrezikut dhe raportet e situatave të krimit; *informatat teknike* i referohen çështjeve të metodologjisë policore, masave administrative të ndërmarra nga forcat policore, etj. Elementin e ngritjes së kapaciteteve në lidhje me atë se si mund të bashkëpunojnë autoritetet e Ballkanit perëndimor me Europol-in,

Analizën e boshllëqeve që ndihmon në identifikimin e problemeve në lidhje me "infrastrukturën e bashkëpunimit" ndërmjet dy palëve,

Mundësinë e këmbimit të zyrtarëve të ndërlidhjes.

Marrëveshjet e bashkëpunimit operativ

Hapi i radhës i paraparë në udhërrëfyesin për viza për shtetet e Ballkanit Perëndimor është "përgatitja për përmbylljen e **marrëveshjeve të bashkëpunimit operativ** me Europol-in me theks të veçantë në dispozitat e mbrojtjes së të dhënave." Marrëveshjet aktuale të bashkëpunimit me shtetet e Ballkanit Perëndimor janë të kufizuara në çështje strategjike siç është këmbimi i informatave mbi veprimet e zbatimit apo vlerësimet e rrezikut. Bashkëpunimi operativ shkon përtej kësaj dhe përfshin, mes tjerash, këmbimin e të dhënave specifike mbi kriminelët, migruesit ilegalë, etj. Megjithatë, kjo kërkon që shtetet e Ballkanit Perëndimor së pari të zbatojnë masa adekuate për **mbrojtjen e të dhënave personale**.

FRONTEX

FRONTEX është agjenci e BE-së me seli në Varshavë, e cila ka hyrë në funksion të plotë prej tetorit të vitit 2005. Qëllimi kryesor i FRONTEX-it është koordinimi i bashkëpunimit operativ ndërmjet shteteve anëtare të BE-së në fushën e sigurisë kufitare. Ajo e arrin këtë përmes një varg aktivitetesh plotësuese. Thelbi i këtyre aktivitetëve është analizimi i rrezikut: identifikimi, vlerësimi dhe priorizimi i rreziqeve të lidhura me sigurinë e kufijve të jashtëm të BE-së. Synimi është arritja e sasisë së "duhur" të mbrojtjes për të përmbysur rrezikun e identifikuar, pa mbrojtje të mangët, por dhe pa mbrojtje të tepërt.

Aktivitetet e FRONTEX përfshijnë koordinimin e aktivitetëve operative të shteteve anëtare të lidhura me sigurinë e kufijve të jashtëm, asistencën në trajnimin e

rojeve kufitare, përcaktimin e standardeve të përbashkëta të trajnimit, dhe hulumtimit në lëmin e kontrollit dhe vëzhgimit kufitar. Po ashtu, kjo agjenci mbështetë shtetet anëtare në identifikimin e praktikave më të mira që kanë të bëjnë me marrjen e dokumenteve të udhëtimit dhe largimin e shtetasve të vendeve të treta.

FRONTEX ka marrëveshje pune me shtete jo anëtare të BE-së në fqinjëri të BE-së. Bashkëpunimi përqendrohet në aktivitetet e përbashkëta operative në fushën e kontrollit kufitar, trajnimeve si dhe në bashkëpunimin teknik në fushën e hulumtimit dhe zhvillimit. Deri në fund të prillit të 2009, FRONTEX ka nisur bashkëpunim formal me autoritetet e zbatimit të ligjit të nëntë shteteve jo-anëtare të BE-së, përfshirë katër nga pesë shtetet pjesëmarrëse në procesin e liberalizimit të vizave (Shqipërinë, Bosnje dhe Hercegovinën, Maqedoninë dhe Serbinë). Pesë shtetet e mbetura janë Kroacia, Gjeorgjia, Moldavia, Rusia dhe Ukraina. Përmbyllja e marrëveshjes së punës me FRONTEX është një nga kërkesat e udhërrëfyesve për viza.

Grupi i shteteve kundër korrupsionit (GRECO)

GRECO është organ monitorues kundër korrupsionit i Këshillit të Evropës. Ai është themeluar në vitin 1999 me seli në Strasburg të Francës. Anëtarësimi në GRECO nuk është i kufizuar në shtetet Evropiane (p.sh. edhe ShBA-të janë anëtare), ndonëse të gjitha shtetet anëtare të Këshillit të Evropës janë edhe anëtare të GRECO. Të pesë shtetet e Ballkanit Perëndimor që marrin pjesë në procesin e liberalizimit të vizave janë anëtarë të Këshillit të Evropës dhe GRECO.

Detyra e kësaj organizate është të identifikojë mangësitë në politikat e shteteve anëtare kundër korrupsionit, posaçërisht për sa i përket standardeve të Këshillit të Evropës kundër korrupsionit, si dhe të sugjerojë reforma legjislative, institucionale dhe praktike.

GRECO synon të zvogëlojë korrupsionin jo duke imponuar sanksione, por përmes vlerësimit të dyanshëm, bindjes dhe presionit. GRECO punon në cikle, të ashtuquajtur xhiro vlerësimi, të cilat zgjasin tri deri në katër vite. Për çdo xhiro vlerësimi zgjidhen tema specifike të cilat pastaj shqyrtohen shtet pas shteti. Xhiroja aktuale, e nisur në 2007, ka të bëjë me dhënien - marrjen e mitos dhe financimin e partive politike. Në fund të xhiros së vlerësimit, GRECO vlerëson zbatimin e rekomandimeve nga çdo shtet anëtar.

Udhërrëfyesit për viza kërkojnë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor që t'i zbatojnë të gjitha rekomandimet e GRECO.

Standardet e ICAO dhe KE në lidhje me informatat biometrike në dokumentet e udhëtimit

Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil, organizatë e OKB-së, përcakton standardet për dokumentet e udhëtimit elektronikisht të lexueshme dhe informatat biometrike që përmbajnë. Për shembull, ajo definon formatet e dosjeve biometrike, kërkesat për fotografitë e fytyrës (p.sh. fotografia e përparme, hapja e syve, pa skuqje të syve) dhe gjurmëve të gishtërinjve, si dhe protokollet e komunikimit që do të përdoren në pasaporta (në mënyrë që t'i bëjë ato të shkëmbyeshme).

Kjo daton qysh në projektin e ONAC të vitit 2003 për integrimin e të dhënave biometrike në pasaporta dhe dokumentet tjera elektronikisht të lexueshme (DEL).

Ndonëse ky ishte vetëm rekomandim, shumica e shteteve tani përdornin standardet e ONAC për të kaluar në pasaporta biometrike, që do të rritë sigurinë dhe mbrojtjen kundër vjedhjes së identitetit dhe falsifikimit të dokumenteve të udhëtimit. Legjislacioni i BE-së për pasaportat biometrik (Rregullorja e Këshillit (EC) 2252/2004 datë 13 dhjetor 2004 dhe aktet e ndërlidhura) po ashtu bazohen në standardet e ONAC. Për më shumë informata shih **Dokumentet e udhëtimit elektronikisht të lexueshme**.

Udhërrëfyesit për viza kërkojnë që shtetet e Ballkanit Perëndimor të lëshojnë dokumente udhëtimi elektronikisht të lexueshme në pajtueshmëri me standardet e ONAC dhe KE. Një gjë e tillë jo vetëm që do të harmonizonte llojin e dokumenteve të udhëtimit të shfrytëzuara në Ballkan me ato që shfrytëzohen në BE, por edhe do të lehtësonte identifikimin dhe kthimin e shtetasve të rajonit që mund të qëndrojnë ilegalisht në BE.

Zbulimi tokësor i migruesve ilegalë

Zbulimi tokësor është strategji e shfrytëzuar nga autoritetet për të kërkuar dhe kapur migruesit ilegalë brenda kufijve të një shteti pasi që të kenë kaluar ilegalisht kufijtë shtetërorë. Koncepti i zbulimit tokësor është kritik për parandalimin e migrimit ilegal, meqë edhe në raste të masave tejet të sofistikuar të kontrollit të kufijve një numër i madh i migruesve ilegalë ia dalin t'i kalojnë kufijtë shtetërorë.

Zbulimi tokësor nuk është i rastësishëm. Ai përqendrohet në të ashtuquajturat "pika lidhëse" – zona ku rrugët e migrimit ilegal takohen apo tejkalojnë, apo nëse shërbimet – si shtëpitë e sigurta dhe transportimi i klandestinëve – ofrohen për migruesit ilegalë.

Shtetet e Ballkanit Perëndimor kërkojnë që të definojnë dhe zbatojnë zbulimin tokësor në mënyrë që të parandalohet tranziti i migruesve ilegalë të shteteve të treta për në BE.

Integriteti dhe siguria e procesit të personalizimit dhe distribuimit të pasaportave

Personalizimi është proces përmes së cilit dokumentet e zbrazëta të pasaportave – të cilat si të tilla nuk janë të shfrytëzueshme – ngarkohen me informata (përfshirë të dhëna biometrike) të personit që do t'i lëshohet pasaporta.

Siguria në procesin e personalizimit është kritike në mënyrë që të sigurohet se të dhënat e ngarkuara në dokument nuk mund të ndryshohen, modifikohen apo vidhen nga mashtruesit dhe kriminelët. Kujdes i ngjashëm është i domosdoshëm gjatë tërë procesit të shpërndarjes për të parandaluar atë që persona të paautorizuar të marrin qoftë pasaportë të zbrazët apo të lëshuar (të personalizuar). Kjo arrihet përmes kontrolleve sistematike në tërë procesin e personalizimit dhe distribuimit, përfshirë zbatimin e vazhdueshëm të parimit të "katër syve" (përmes së cilit një detyrë e rëndësishme gjithmonë ndahet nga dy apo më shumë persona, ku ideja është se është më e vështirë të korruptohen dy individë sesa një) dhe zbatimi i "ndarjes së detyrave" (ku detyrat e vështira një procesi më të madh i caktohen individëve të ndryshëm, ashtu që asnjë person i vetëm të mos të ketë kontroll të plotë të procesit, duke bërë që mashtrimi të jetë shumë më i vështirë). Po ashtu shfrytëzohen kontrollet teknike si komunikimi i enkriptuar, si dhe një nivel i lartë i automatizimit me ndërhyrje minimale njerëzore – përsëri zvogëlohen mundësitë e mashtrimit.

Baza e të dhënave LASP/SLTD

Interpoli mirëmban të ashtuquajturën bazë të të dhënave DVHU (Dokumentet e Vjedhura dhe të Humbura të Udhëtimit). Baza e të dhënave mban regjistrat të miliona pasaportave, kartelave të udhëtimit dhe vizave që janë raportuar si të vjedhura apo të humbura. Ajo u mundëson autoriteteve kufitare në mbarë botën që menjëherë të kontrollojnë nëse dikush është duke tentuar të hyjë në shtet me pasaportë të vjedhur dhe identitet të rrejshëm. Prandaj, baza e të dhënave është masë kyçe për zbulimin e kriminelëve dhe migruesve ilegalë. Shtetet e Ballkanit Perëndimor kërkojnë t'i raportojnë bazës së të dhënave DVHU të Interpolit.

Dokumenti i udhëtimit biometrik elektronikisht i lexueshëm

Dokument i udhëtimit që përmban informata biometrike elektronikisht të lexueshme mbi bartësin e tij. Informatat biometrike mbështeten në karakteristika fiziologjike (gjurmët e gishtërinjve, forma e iridës, gjeometria e dorës, fytyra, zëri, forma e veshit) apo karakteristikat e sjelljes (nënshkrimi), duke i lejuar autoritetet që në mënyrë të shpejtë dhe të saktë të vërtetojnë identitetin e personit duke dëshmuar se zotëruesi i identifikimit është në të vërtetë ai që pretendon të jetë. Informatat biometrike mund t'i ofrojnë shërbimeve kufitare, apo organeve tjera hetuese, mjete për gjetjen e informatave në baza të të dhënave; për shembull, për të verifikuar nëse një person ka hyrë më parë në zonën e Shengenit me emër tjetër. Prandaj, dokumentet biometrike të udhëtimit shihen si pjesë kyçe e luftës kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe imigrimit ilegal.

Në vitin 2004 shtetet anëtare të BE-së miratuan Rregulloren e Këshillit 2252/2004, sipas së cilës të gjitha pasaportat e reja të BE-së duhet të jenë elektronikisht të lexueshme dhe të përfshijnë (prej vitit 2006 e tutje) fotografi digjitale të zotëruesit dhe (prej vitit 2009) gjurmët e gishtërinjve. Informatat biometrike ruhen në një çip në pasaporta dhe në bazat shtetërore të të dhënave si dhe në Sistemin Informativ të Shengenit II (SIS II). SIS II është pasardhës i modernizuar dhe i përmirësuar i SIS, i cili u mundëson autoritetet vendore në shtetet e Shengenit të ndajnë informata mbi politikën dhe personat që tentojnë të kalojnë kufirin apo të cilët dëshirojnë të sigurojnë viza.

Menaxhimi i migrimit

Migrimi çdo herë e më shumë perceptohet si tipar kyç i ekonomisë globale. Ky lloj i të kuptuarit ka shpjerë drejt ndryshimit të konceptit sa i përket caqeve strategjike të politikave të migrimit – nga *kontrollimi dhe ndalimi* i migrimit në *menaxhimin* e tij .

Organizata Ndërkombëtare për Migrim (ONM), organizatë udhëheqëse ndërqeveritare në fushën e migrimit, përshkruan qëllimin e menaxhimit të migrimit si ofrim i ndihmës për të bërë që potenciali social dhe ekonomik i migrimit t'i ndihmojë *migruesve individualë si dhe shoqërive në tërësi*. Ky model kërkon "menaxhimin e migrimit në mënyrë të rregulluar" ndërsa gjithashtu "vë kontroll mbi migrimin e parregullt." I njëjti përfshin zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse të migrimit që bazohen në të dhënat e shumta empirike mbi lëvizjet e migrimit dhe që përkrahen nga legjislati dhe strukturat administrative përkatëse. Grumbullimi i informatave për qëllim të menaxhimit të migrimit ka si parakusht bashkëpunimin e thuktë në nivel kombëtar mes shërbimeve të ndryshme që ofrohen brenda vendit dhe ministrive, si dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Monitorimi i rrjedhave të migrimit

Udhërrëfyesit e vizave kërkojnë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të vënë në funksion mekanizma për **monitorimin e rrjedhave të migrimit**, për të azhurnuar rregullisht **profilet e migrimit** në shtetet e tyre dhe për të krijuar organe përgjegjëse për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave mbi migrimin dhe rrjedhat e tij. Obligimi për të monitoruar rrjedhat e migrimit ngërthen mbajtjen e regjistrave dhe shënimeve sa i përket shifrave dhe strukturës së migrimit legal dhe ilegal.

Profilet e migrimit

Profilet e migrimit grumbullojnë dhe analizojnë të dhënat relevante për migrimin në të gjitha shtetet. Ato zakonisht përfshijnë të dhëna mbi imigrantët, emigrantët, paratë e dërguara nga bashkatdhetarët që jetojnë jashtë, komunitetet migruese, dhe migrimin e parregullt; ato gjithashtu ofrojnë një pasqyrë të politikave të migrimit dhe kornizës ligjore të aplikueshme. Në përgatitje për kryesim të BE-së në vitin 2008, Qeveria e Sllovenisë kërkoi nga IOM të hartojë profilet e migrimit për të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor si dhe për Turqinë. Këto dokumente janë finalizuar në vitin 2007 dhe tani duhet të azhurnohen nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor.

Shpëlarja e parave

Shpëlarja e parave është akt i fshehjes së origjinës së vërtetë të parave të fituara në mënyra joligjore. Nëse kjo vepër ka sukses, paratë e shpëlarura humbin "identitetin kriminal" të tyre dhe praqiten si të ligjshme. Vepra penale e shpëlarjes së parave *nuk* kufizohet vetëm në fshehjen e origjinës së të ardhurave nga krimi i organizuar (siç është shitja e drogës, trafikimi i armëve dhe prostitucioni), por gjithashtu ka të bëjë me pasuritë dhe vlerat e gjeneruara përmes transaksioneve të paligjshme financiare (korrupsionit, evazionit fiskal, mashtrimeve financiare).

Një shembull tipik i shpëlarjes së parave është i ashtuquajturi "*smurfing*". Një vlerë e madhe e parave të gatshme (kesh), p.sh. 100,000 €, ndahet në vlera më të vogla, p.sh. nga 10,000 € dhe depozitohen nga individë të ndryshëm në llogari të ndryshme: këto vlera më tej barten në llogarinë e pronarit të vërtetë të parave të paligjshme. Ndarja e vlerës më të madhe të parave në sasi më të vogla është kyçe, pasi që pagesat në llogari bankare nën një limit të caktuar nuk raportohen tek trupat mbikëqyrëse financiare. Format tjera të shpëlarjes së parave janë më komplekse dhe mund të shfrytëzojnë pagimin e ratave të kredive false apo faturat e falsifikuara si mbulesë; ndërsa format tjera përfshijnë depozitimin e vlerave të mëdha të keshit në banka të largëta të cilat nuk i nënshtrohen ndonjë regjimi strikt të drejtuar kundër shpëlarjes së parave (ekzistojnë një sërë qendrash të tilla financiare, për shembull Barbadosi, Ishujt Kajman, Belizeja, etj.).

Akti kryesor ligjor i BE-së sa i përket shpëlarjes së parave është Direktiva mbi "Shpëlarjen e parave: parandalimi i shfrytëzimit të sistemit financiar", e miratuar në vitin 2005. Qëllimi i Direktivës është të parandalojë shfrytëzimin e sistemit financiar për qëllime të shpëlarjes së parave apo financimit të terrorizmit. Kjo Direktivë kërkon nga institucionet financiare që të kenë kujdes të duhur me konsumatorët, do të thotë se duhet të hetojnë prapavijën e konsumatorit potencial financiar. Ato gjithashtu duhet të monitorojnë dhe raportojnë të gjitha transaksionet e dyshimta në vendin e tyre tek Njësia për Inteligjencë Financiare (NJIF) përkatëse e shtetit të tyre. Krijimi i NJIF është i përcaktuar në Direktivën e BE-së.

Nga vendet e Ballkanit Perëndimor kërkohet që të miratojnë dhe zbatojnë strategjitë kombëtare për parandalimin dhe luftimin e shpëlarjes së parave duke përfshirë masa legjislative kur është e nevojshme dhe të zbatojë konventat relevante të OKB-së dhe Këshillit të Evropës në këtë fushë.

**Menaxhimi i
Integruar i
Kufijve Kombëtar**

Menaxhimi i Integruar i Kufijve Kombëtar është koncept për të integruar dhe optimizuar bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar brenda dhe ndërmjet agjencive dhe shërbimeve që janë përgjegjëse për menaxhim të kufijve. Agjenci të tilla janë policia kufitare, administrimi i doganave, dhe inspektionet veterinarë dhe fitosanitare. Dy qëllimet kryesore të menaxhimit efikas të kufijve janë: (a) lehtësimi i lëvizjes së personave dhe mallrave legjitime, dhe (b) parandalimi i hyrjes së mallrave të kontrabanduara, lëndëve narkotike, armëve, migrantëve ilegalë, dhe trafikimit me qenie njerëzore; ndalohej shpërndarja e sëmundjeve ngjitëse tek njerëzit, kafshët dhe bimët; dhe luftimi i kërcënimeve terroriste.

Në mënyrë që të arrihen këto synime kyçe, koncepti i Menaxhimit të Integruar të Kufijve në nivel kombëtar për shtetet e Ballkanit Perëndimor thekson bashkëpunimin më të mirë dhe integrimin në tri nivele:

Bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve
Bashkëpunimin –ndërmjet agjencive
Bashkëpunimin ndërkombëtar

Integrimi në këto tri nivele, dhe mes tyre, arrihet përmes një pakoje gjithëpërfshirëse të aktiviteteve dhe mjeteve që përfshijnë masat e ndërlidhura me kornizën ligjore dhe rregullative, strukturat organizative dhe menaxhimentin, procedurat, resurset njerëzore dhe trajnimet, komunikimin, teknologjinë informative, infrastrukturën dhe pajisjet, dhe buxhetin.

Koncepti i menaxhimit të integruar të kufijve gjithashtu zbatohet në shtetet e zonës së Shengenit, megjithëse në rastin e tyre theksi vihet në bashkëpunimin mes autoriteteve kufitare të shteteve të ndryshme dhe në krijimin e një kornize të përbashkët ligjore. Kjo daton nga Komunikata e Komisionit Evropian, e datës 7 maj 2002 (dokument politik) mbi menaxhimin e integruar të kufijve të jashtëm të BE-së, parimisht në mënyrë që të ndalohej migrimi ilegal dhe të luftohej terrorizmi (më shumë informata nga Komisioni Evropian mbi këtë çështje mund të gjenden këtu). Bazuar në këtë Komunikatë, janë miratuar një sërë masash legjislative. BE-ja aktualisht po shtjellon shfrytëzimin e një sërë veglash të reja për menaxhimin e kufijve, përmes të cilave do përmirësoheshin kontrollet në kufij dhe do të regjistroheshin të gjitha hyrjet në BE.

**Strategjia
Kombëtare për
Reintegrimin e të
Kthyerve**

Sipas **marrëveshjeve për ripranim** të nënshkruara mes BE-së dhe shteteve të Ballkanit Perëndimor, vendet e Ballkanit Perëndimor obligohen të ndërmarrin masa për të reintegruar të kthyerit që janë kthyer nga BE-ja. Këto masa përfshijnë lëshimin e dokumenteve personale, akomodimin e përkohshëm dhe mbrojtjen sociale, kujdesin shëndetësor dhe arsimimin për fëmijët.

Aktivitetet e ndërlidhura me reintegrimin e të kthyerve bën të domosdoshëm bashkëpunimin mes ministrive të ndryshme dhe organeve qeveritare. Organet e rëndësishme qeveritare në këtë kuptim përfshijnë Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ministrinë e Punës dhe organet e administratës lokale. Strategjia Kombëtare për Reintegrimin e të Kthyerve – miratimi i të cilës është kusht i udhërrëfyesit për vizat – koordinon dhënien e përkrahjes bazike për të kthyerit nga akterët në fjalë.

**Ligji për
Mbrojtjen e të
dhënave**

Mbrojtja e të dhënave personale është një fushë e ligjit që merret me të drejtën e individit në privatësi, nga këndvështrimi i grumbullimit dhe ruajtjes së të dhënave personale. Koncepti i mbrojtjes së të dhënave personale bazohet në parimet

personale

themelore të të drejtave të njeriut, siç është e drejta në privatësi, e rregulluar me Nenin 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore.

Sfida që paraqitet në legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave qëndron në arritjen e balancit mes mbrojtjes së privatësisë në nivel të lartë dhe lirisë së qarkullimit të të dhënave personale për qëllime legjitime, kryesisht në fushën e tregtisë (p.sh. informatat mbi konsumatorët) dhe të administratës (p.sh. të dhënat e qytetarëve për arsye tatimore, të fondeve pensionale dhe beneficioneve sociale). Niveli i mbrojtjes së të dhënave personale më tej kufizohet “në mënyrë që të mbrohen aspektet e sigurisë kombëtare, mbrojtjes, sigurisë publike, përndjekjes së veprave penale.”

Në BE, një sërë Direktivash i qasen kësaj çështje, nga të cilat më të rëndësishmet janë Direktiva 95/46/EC mbi “mbrojtjen e individëve sa i përket procedimit të të dhënave personale dhe lëvizjes së lirë të dhënave të tilla” dhe Direktiva 2002/58/EC mbi “privatësinë e komunikimit elektronik”. E para forcon më tej Konventën e Këshillit të Evropës nga viti 1981 për Mbrojtjen e Individëve sa i përket Përpunimit Automatik të të Dhënave Personale dhe Protokollit Shtesë të saj nga viti 2001, të cilën është dashur ta nënshkruajnë, ratifikojnë dhe implementojnë shtetet e Ballkanit Perëndimor. (Për informata të mëtejme mbi mbrojtjen e të dhënave personale në BE, klikoni këtu.)

Direktiva 95/46/EC kërkon që gjatë përpunimit të të dhënave personale “të [zbatohen] masa të përshtatshme për të ruajtur të dhënat nga shkatërrimi aksidental apo i paligjshëm apo humbja, ndryshimi, zbulimi i paautorizuar i tyre, dhe nga qasja në to.” Direktiva më tej thekson se bartja e të dhënave personale nga shtetet anëtare të BE-së tek shtetet jashtë BE-së mund të autorizohet vetëm kur shtetet në fjalë të kenë siguruar “nivel adekuat të mbrojtjes” së të dhënave personale.

Vendosja e bashkëpunimit operativ mes organeve zbatuese të ligjit të shteteve të Ballkanit Perëndimor dhe shteteve të BE-së, në mënyrë që të dhënat personale të kriminelëve, migruesve ilegalë, etj. të mund të këmbehen, duhet të kalojë parakushtin që shtetet e Ballkanit Perëndimor të kenë sisteme adekuate të mbrojtjes së të dhënave.

Marrëveshja për ripranim

Marrëveshje mes BE-së dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE-së lidhur me ripranimin e personave të cilët nuk përmbushin kushtet për të qëndruar apo banuar në territorin e njëres nga dy palët në marrëveshje dhe të cilët janë (a) shtetas të palës tjetër, apo (b) shtetas të një shteti të tretë por që kanë kaluar përmes territorit të palës tjetër.

Përkundër karakterit të reciprocitetit të marrëveshjeve të ripranimit, çështja kryesore është prezenca ilegale e joshtetasve të BE-së në BE dhe jo anasjelltas. Praktikisht, marrëveshjet për ripranim lehtësojnë largimin e banorëve ilegalë dhe kthimin e tyre në shtetin e origjinës apo transitit. Ato paraqesin pjesë të strategjisë së BE-së për luftimin e imigrimit ilegal.

Marrëveshjet bilaterale për ripranim

Komisioni Evropian ka filluar me negociimin e marrëveshjeve për ripranim në emër të BE-së gjatë vitit 2000. Marrëveshja e parë për ripranim e Komunitetit, me Hong Kongun, ka hyrë në fuqi më 1 mars të vitit 2004. Më parë shtetet anëtare të BE-së kanë nënshkruar marrëveshje bilaterale të ripranimit me shtetet që nuk janë anëtare të BE-së.

Çështja e ripranimit është përhapur gradualisht në sferat tjera politike të BE-së,

siç janë tregtia, ndihma zhvillimore dhe marrëdhëniet e jashtme, pasi që BE ka kërkuar mënyra për t'i bindur shtetet nga të cilat migruesit hyjnë në BE të nënshkruajnë marrëveshjet për ripanim. Mes vitit 2004 (Programi i Hagës) dhe 2005 BE-ja përfundimisht vendosi të ofrojë *lehtësimin e vizave* në raste të caktuara, si masë stimuluese për arritjen e marrëveshjeve të ripranimit.

BE-ja gjithashtu ka vendosur që këtë pako t'ia ofrojë shteteve me perspektivë evropiane, siç janë ato të Ballkanit Perëndimor (edhe pse shumica e shteteve të BE-së veç kanë marrëveshje bilaterale me këto shtete). Arsyeja kryesore bazohet në diplomaci dhe trajtim të barabartë: do të ishte e çuditshme – madje e padrejtë – që t'i ofrohen procedura më të lehta të aplikimit për viza shteteve më të largëta por jo shteteve potencialisht candidate për të qenë anëtare të BE-së.

Marrëveshjet e BE-së me Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën, Maqedoninë, Malin e Zi dhe Serbinë për ripanim dhe lehtësim të vizave kanë hyrë në fuqi më 1 janar 2008, përveç marrëveshjes për ripanim me Shqipërinë e cila ka hyrë në fuqi më 1 maj 2006. (Për informata të mëtejme mbi marrëveshjet me shtetet e Ballkanit Perëndimor, shihni *Origina* dhe Marrëveshjet për Lehtësim të Vizave dhe të Ripranimit.)

Protokollet e implementimit

Procedurat e sakta të ripranimit janë detajuar në të ashtuquajturat protokolle implementimi mes shteteve anëtare të BE-së dhe shtetit përkatës që nuk është anëtar i BE-së. Protokollet implementuese zakonisht përfshijnë çështjet siç janë përcaktimi i autoriteteve kompetente, pikat e kalimit kufitar në dispozicion, detaje mbi komunikimin (p.sh. gjuha), kushtet e kthimit me përcjellje dhe dokumentet e domosdoshme për realizimin e ripranimit.

Dokumentet standarde të udhëtimit të BE-së për qëllime të dëbimit

Personat, ripranimi i të cilëve është pranuar nga shteti i origjinës apo transitit mund të pajisen me **dokumente standarde të udhëtimit të BE-së për qëllim të dëbimit**, të cilin shtetet e origjinës apo transitit obligohen ta pranojnë. Nevoja për dokumente të tilla parashtrohet nëse personat që duhet ripranuar kanë shkatërruar dokumentet e tyre identifikuese dhe refuzojnë të zbulojnë identitetin e tyre apo nëse shteti pranues nuk mundet teknikisht, apo refuzon, t'i lëshojë dokumentin e domosdoshëm të identitetit apo të udhëtimit.

Refugjatët dhe Personat e Zhvendosur Brenda Vendit (IDP)

Komisioneri i Lartë i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), agjenci kjo udhëheqëse e OKB-së për mbrojtje të refugjatëve, përkufizojnë termin refugjatë si "persona që janë detyruar ta lëshojnë shtetin e tyre për shkak të përndjekjes, luftës apo dhunës. Refugjatët kanë frikë të bazuar nga përndjekja për shkak të racës, fesë, kombësisë, mendimit politik apo të qenit pjesë e ndonjë grupi të posaçëm social". Çështje kyçe për definimin e termit të refugjatit është që ky person të ketë kaluar një kufi ndërkombëtar. Statusi ligjor i **refugjatëve** rregullohet me Konventën për Refugjatët të vitit 1951 dhe Protokollin e saj të vitit 1966 (që gjithashtu njihet si *Konventa e Gjenevës me Protokollin e Nju Jorkut*).

Udhërrëfyesit kërkojnë nga shtetet e Ballkanit Perëndimor të zbatojnë këtë konventë. Një nga dispozitat më të rëndësishme të saj është ajo që rregullon se asnjë shtet nuk mund të largojë apo kthejë refugjatët kundër dëshirës së tyre në vendet ku refugjatët kanë frikë nga përndjekja (parimi *non-refoulement*).

PZHBV

PZHBV (IDP-të) janë persona të cilët janë detyruar të largohen nga shtëpitë e tyre për të njëjtat shkaqe si edhe refugjatët. Megjithatë, ndryshe nga refugjatët,

PZHBV -të mbesin në vendin e tyre, do të thotë nuk kalojnë përtej kufijve ndërkombëtarë. Ligjet ndërkombëtare të refugjatëve nuk zbatohen edhe për IDP-të, të cilët i nënshtrohen ligjeve të shtetit të tyre. Pasi që nuk ka ndonjë akt legjislativ ndërkombëtar që adreson specifikisht çështjen e **PZHBV** -ve, UNHCR ka përpiluar Parimet Udhëzuese mbi Zhvendosjen Brenda Vendit, dokument ky që përmbledh të drejtat dhe garancitë për mbrojtjen e **PZHBV** -ve. Këto parime udhëzuese reflektojnë, dhe janë në pajtim me, të drejtat ndërkombëtare të njeriut dhe me të drejtën ndërkombëtare humanitare.

Marrëveshja Shengen

Marrëveshje e nënshkruar në vitin 1985 nga Belgjika, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda për anulimin e kontrolleve kufitare dhe krijimin e një zone për lëvizje të lirë të njerëzve dhe mallrave. Kjo marrëveshje u përcoll në vitin 1990 me Konventën e Shengenit, e cila definonte masat e domosdoshme për implementim. Që nga krijimi i saj, zona e Shengenit është zgjeruar disa herë. Tani ajo mbulon 25 shtete Evropiane dhe një popullatë prej afro 400 milionë banorë.

Derisa Marrëveshja fillestare e Shengenit ishte thjesht një traktat i nënshkruar ndërmjet pesë shteteve, nga 1999 e tutje marrëveshja dhe të gjitha aktet ligjore të ndërlidhura me të janë bërë pjesë e legjislacionit të BE-së (acquis e BE-së). Këto dispozita janë të obligueshme për shtetet që i bashkohen BE-së.

Megjithatë, jo të gjitha shtetet e BE-së marrin pjesë plotësisht në këtë marrëveshje: Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar kanë zgjedhur të mbajnë kontrollet e kufijve, ndërsa Bullgaria, Qiproja dhe Rumania ende duhet të zbatojnë disa dispozita të caktuara për të arritur integrimin e plotë. Danimarka ka të drejtë të zgjedhë nëse do të aplikojë disa masa të caktuara apo jo. Njëkohësisht, tri shtete që nuk janë anëtare të BE-së, Islanda, Norvegjia dhe Zvicra, janë tërësisht të integruara.

Anulimi i kontrolleve të kufijve të brendshëm ka shkuar krah për krah me kontrolle më të fuqishme të kufijve të jashtëm për zonën që ka miratuar këtë traktat. Në mënyrë që të arrihet efikasitet dhe siguri e shtuar sa i përket regjimit kufitar të zonës Shengen, gjithashtu ishte e domosdoshme të harmonizohen politikat dhe masat administrative në fushat tjera politike, siç janë imigracioni dhe politikat e vizave, kontrolli ndërkufitar nga policia dhe bashkëpunimi gjyqësor.

Listat e bardha dhe të zeza të Shengenit

SIS dhe SIV

Një akt ligjor i BE-së (Rregullorja e Këshillit Nr.539/2001) liston shtetet, qytetarëve të të cilave u nevojitet viza për të hyrë në zonën e Shengenit (Lista e Zezë e Shengenit) dhe të atyre qytetarëve të të cilave nuk u nevojitet ajo (Lista e Bardhë e Shengenit). Sistemi i kompjuterizuar i informimit (SIS – Sistemi Informativ i Shengenit) u mundëson autoriteteve shtetërore të shteteve të Shengenit, këmbimin e informatave lidhur me sigurinë e kufijve (përfshirë personat që mëtojnë të hyjnë në BE apo të marrin vizë) dhe me zbatimin e ligjit. Një sistem i ngjashëm është duke u krijuar për t'i mundësuar shteteve të Shengenit këmbimin e informatave mbi hyrjen dhe daljen e personave që kanë për obligim marrjen e vizës (SIV – Sistemi Informativ i Vizave).

Këtu mund të gjeni informata të mëtejme mbi zonën e Shengenit, që janë dhënë nga Komisioni Evropian.

Trafikimi me qenie njerëzore

Trafikimi me qenie njerëzore është akt i rekrutimit, transportimit, mbajtjes apo pranimit të personit për qëllim të punës së dhunshme, skllavërisë – përfshirë skllavërinë për qëllime seksuale – dhe formave tjera të punës së obliguar. (Punëtorët e obliguar punojnë për të shpërndarë borxhin, për shembull për pagesën

që u është kërkuar për tu kontrabanduar në BE. Marrëdhënia mes punëtorëve të obliguar dhe patronëve të tyre përshkohet nga eksploatimi dhe nuk përfshin pagesë të drejtë për punën e bërë.) Viktimat e trafikimit me qenie njerëzore zakonisht rekrutohen dhunshëm, apo në bazë të mashtrimit e falsifikimit; shpesh janë të obliguar në borxhe.

Trafikimi me qenie njerëzore është i ndryshëm nga migrimi ilegal apo kontrabandimi i migrantëve. Kyç për definimin e trafikimit është nocioni i eksploatimit të dhunshëm të migrantit pasi ai apo ajo të ketë kaluar kufirin. Kjo nuk ndodh kur migrantët kontrabandohen në një shtet apo kur hyjnë në një shtet ilegalisht dhe kërkojnë punësim ilegal atje.

Trafikimi me qenie njerëzore është ngushtë i lidhur me krimin e organizuar dhe shpesh përshkruhet si formë moderne e skllavërisë. Shumica e viktimave janë gra, ndërsa që eksploatimi seksual paraqet arsyen më të shpeshtë për trafikimin e tyre.

Në BE, legjislacioni kornizë për trafikimin me qenie njerëzore (Vendimi Kornizë i Këshillit 2002/629/JHA e datës 19 korrik 2002) merret me çështje si kriminaliteti, sanksionimin, rrethanat vështirësuese, juridiksioni, ekstradimi dhe bashkëpunimi politik dhe gjyqësor. (Informata të mëtejme mbi veprimet e BE-së kundër trafikimit me qenie njerëzore mund të gjenden këtu.)

Një numër konventash ndërkombëtare gjithashtu adresojnë çështjen e trafikimit me qenie njerëzore, nga të cilat më të rëndësishmet janë Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar Transnacional, e miratuar në vitin 2000, dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Veprim Kundër Trafikimit me Qenie Njerëzore, e miratuar në vitin 2005. Grupet e avokimit e madje edhe disa organizata të OKB-së çdo herë e më shumë trafikimin me qenie njerëzore e konsiderojnë krim kundër njerëzimit.

Marrëveshja për lehtësim të vizave

Një marrëveshje, me qëllim të thjeshtësimit të procedurës së aplikimit për viza, mes BE-së dhe shteteve që nuk janë anëtare të BE-së qytetarët e të cilave obligohen të marrin viza. Në rastin e Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë, përmbyllja e marrëveshjeve për lehtësim të vizave ka qenë e lidhur me përmbylljen e **marrëveshjeve për ripranim**. Marrëveshjet për lehtësim të vizave dhe ripranim kanë hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2008, përveç marrëveshjes për ripranim me Shqipërinë ka hyrë në fuqi më 1 maj 2006.

Marrëveshjet për lehtësim të vizave me shtetet e Ballkanit Perëndimor ofrojnë një sërë përmirësimesh në krahasim me regjimin e rëndomtë të vizave: (a) afati prej 10 ditësh kalendarike për përpunimin e aplikacionit të vizës; (b) lista e specifikuar qartas e dokumenteve të kërkuara për të demonstruar qëllimin e udhëtimit; (c) pagesa e zvogëluar për vizë prej 35 eurosh (viza e Shengenit normalisht kushton 60 euro) krahas lirit nga pagesa për shumë grupe aplikuesish, siç janë familjarët e afërm, fëmijët, pensionistët, studentët, atletët, gazetarët, etj.; dhe (d) mundësia që të merren viza më afatgjata dhe me më shumë hyrje, në veçanti nga udhëtuesit më të shpeshtë. Për më shumë informata shihni *Origjina* dhe Marrëveshja për Lehtësimi të Vizave dhe Marrëveshja për Ripranim..

Norma e refuzimit të vizës dhe norma e refuzimit të hyrjes

Në kaptinën e emërtuar "Vërejtja Përfundimtare", udhërrëfyesit e vizave përcaktojnë se Komisioni Evropian, gjatë vlerësimit të gatishmërisë së shtetit për të udhëtuar pa viza, gjithashtu do të merr parasysh kritere të ndryshme "siç janë norma e refuzimit të vizave për aplikantët dhe norma e refuzimit të hyrjes në zonën e përbashkët të Shengenit për shtetasit [e vendit]. Në këtë kontekst, trendi i rënies së normës së refuzimit, i cili duhet të shkojë drejt normës prej 3% për

viza dhe 1,000 persona në vit të cilëve u është refuzuar hyrja në zonën e përbashkët të Shengenit, do të shfrytëzohet si referencë indikative.”

Të dyja këto kushte kanë shkaktuar kundërtënie mes shteteve anëtare të BE-së dhe është pikëpyetje nëse pajtueshmëria me to do të merret në konsideratë.

Norma e refuzimit të vizës

Norma e refuzimit të vizës, e shprehur në përqindje, paraqet thjeshtë normën e vendimeve negative mbi aplikacionet e vizave. Në teori, norma e ulët e refuzimit mund të jetë treguese se qytetarët e një shteti nga Ballkani Perëndimor në përgjithësi nuk konsiderohet se paraqesin rrezik: do të thotë se nuk ka të ngjarë se do të rrinë më gjatë se viza e parashtron në zonën e Shengenit si imigrantë ilegalë; dhe se nuk ka të ngjarë të bëjnë çfarëdo kundërvajtjesh.

Megjithatë, bazimi në normën e refuzimit si standard është problematik. Së pari, shtetet e Shengenit obligohen të grumbullojnë statistika të vizave dhe këto të dhëna t'i vënë në dispozicion të Këshillit, i cili ato i publikon në baza vjetore; megjithatë, të dhënat ndonjëherë nuk përputhen (p.sh. numri i aplikacioneve të vizave nuk përputhet me shumën e numrit të aplikacioneve të miratuara dhe mohuara). Gjithashtu, për Komisionin do të ishte vështirë të nxirren të dhëna më të azhuruara në muajt e fundit.

Së dyti, statistikat jo gjithmonë pasqyrojnë situatën e një shteti. Për shembull, shumë shtete të BE-së nuk kanë zyra konsulare në Kosovë, rrjedhimisht Kosovarët aplikojnë për viza në konsulata në Maqedoni, dhe kështu i 'shtrembërojnë' statistikat e Maqedonisë. Së treti, norma e refuzimit të vizave shpesh varet nga politikat e ndryshme të vizave të shteteve të ndryshme (statistikat tregojnë se Gjermania dhe Austria refuzojnë më shumë aplikacione për viza se sa, le të themi, Italia) dhe nga fakti nëse konsulatat ofrojnë informata të mjaftueshme (aplikantët që janë mirë të informuar, që dinë saktësisht se cilat janë kushtet për marrje të vizave, kanë gjasa më të mira që në fakt të marrin atë).

Norma e refuzimit të hyrjes

Norma e refuzimit të hyrjes në zonën e përbashkët të Shengenit paraqet normën e personave të cilëve u ndalohet hyrja në kufijtë e jashtëm të zonës së Shengenit (për shembull, për shkak se nuk kanë vizë të domosdoshme apo për shkak se policia kufitare apo shërbimi doganor ka vërejtur parregullsi). Megjithatë, ekziston një problem fundamental sa i përket insistimit të BE-së që norma e refuzimit të hyrjes për shtetasit e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor të jetë rreth 1,000 persona në vit. Serbia ka 7,4 milionë banorë, ndërsa Mali i Zi 650,000 sish. Nuk është e drejtë që të pritët nga të dyja këto vende të kenë numër të njëjtë të hyrjeve të refuzuara. Krahas kësaj, edhe në këtë rast Komisioni do ta kishte tejet vështirë të mbledh informatat relevante me kohë.